RAPORT TEKNIK STRUKTUROR

Objekti:

“RIKOMPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHIJË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE”

Projektim - Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

ABSTRAKT

Në këtë analizë kemi të bëjmë me një object I cili do të studiohet nga ana strukturore me qëllim vlerësimin e kushteve dhe gjendjes së godinës, kryesisht në lidhje me performancën dhe kapacitetin sizmik. Metodologjia përfshin prova in site (në terren), teste laboratorike, studim sizmiologjik të ndërtesës duke analizuar sizmicitetin e zonës, aplikim të metodave analitike të llogaritjeve. Ngarkesat sizmike janë vlerësuar duke u bazuar në metoda bashkëkohore si dhe në koncepte të përdorura më parë. Një kontroll I imtësishëm është realizuar nga grupi topografik në lidhje me kontrollin e vertikalitetit të strukturës. Ky dokument paraqet një procedurë të mirë ezauruar mbi vlerësimin e kapacitetit sizmik të strukturës me konstruksion mbajtës tullë e plotë, në rastin e eventeve sizmike të fuqishme. Analiza që kryhet është gjithë përfshirëse, për ndërtesën në shkallë globale dhe për elementët e vecantë në nivel local me fokus zonat me predispozim më të lartë ndaj humbjes së qëndrueshmërisë dhe shkatërrimit. Analiza e strukturës ekzistuese kryhet nëpërmjet modelimit me Metodën e Elëmëntëve të fundëm me programe të avancuara kompjuterike, metodë e cila mundëson zgjidhje efektive dhe saktësi shumë të lartë duke përfshirë sjelljen brenda dhe jashtë planare të elemtëve, për të arritur në një vlerësim përfundimtar mbi mekanizmat e kolapsit dhe global, si edhe performancën sizmike të strukturës. Mbi bazën e rezultateve të analizës së mësipërme është arritur në konkluzionet dhe rekomandimet e analizës së thelluar dhe është përpiluar projekti I ndërhyrjes rehabilituese. Projekti I ndërhyrjeve është hartuar mbi bazën e kushteve teknike në fuqi për vendin tonë si dhe atyre europiane EC - eurocodeve në fuqi. Për objektin që I është kërkuar ti nënshtrohet analizës së thelluar është bërë azhornimi dhe dokumenti I plotë gjeometrik dhe teknik in site si procedure pararendese e akt ekspertizës së thelluar dhe analizës strukturore të thelluar. Sipas matjeve dhe vëzhgimeve faktike, është bërë detajimi gjeometrik, planimetritë e objektit ekzistues, planet e strukturave dhe të dimensionimeve gjeometrike të elementeve strukturale. Bazuar në të dhënat e mësipërme, do të realizohet modeli matematikor analitik me elemente të fundëm I struktures.

Projektim - M... - Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

PËRMBAJTJA/PASQYRA

1. **AKTEKSPERTIZA**
    a. Mbledhja e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe Teknik për objektin si psh:
        i. Projekti arkitektonik
        ii. Projekti konstruktiv
        iii. Lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse
        iv. Studimi sizmik
        v. Procesverbalet e punimeve të maskuara
        vi. Raporti I llogaritjes së strukturës
    b. Evidentimi I ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit dhe kohën e shfrytëzimit
    c. Përditësimi gjeometrik I objektit
    d. Mbledhja e dokumentacionit të zbatimit
    e. Katalogimi I dëmtimeve në object
    f. Gjykimi Inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit dhe të shkallës së dëmtimeve të mundshme
    g. Konkluzionet për origjinën (nëse ka dëmtime) e dëmtimeve dhe përcaktimin e nivelit të dëmtimeve

2. **ANALIZA E THELLUAR**

a. Studimi i dokumentacionit gjeometrik dhe teknik te ohjektit pa dokumentacion teknik
b. Studimi i stmkturave sipas percaktimeve te SSH EN 1998-3:2005:
    i. Studimi gjeometrik
    ii. Studimi i materialit
c. Studimi i strukturave, qe do te shoqerohet me kryerjen e testeve, me shkaterrim dhe pa shkaterrim, sipas percaktimeve _te dhena ne standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde te tjera te barasvlefshme mete
d. Projektin stimulues bazuar ne kushtet ne fuqi
e. Evidentimi dhe katalogimi I dëmtimeve të mundshme
f. Analiza lineare, sipas percaktimeve te dhena ne standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknik.e dhe/ose standardeve te tjera te barasvlefshme me te, te persbtatshme per tipin e struktures. Ngarkimi sizmik te behet sipas procedures se caktuar ne standardin shqiptar SSH EN 1998- 3 :2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde te' tjera te barasvlefshme
g. Analiza Jo lineare sipas percaktimeve te dhena ne standartin shqiptar SSH EN 1998, per tipin e struktures
h. Konkluzioni per peformancën e godinës, sipas metodologjise bazuar ne standardin shqiptar per sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas percaktimeve ni! specifikimet teknike dhe/ose standardeve te tjera te barasvlefshme me standardin shqiptar per sizmicitetin
i. Rekomandime per ndërhyrjet strukturale te nevojshme për kthim të struktures konform kushteve teknike dhe pershtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhelose standardeve të tjera te barasvlefshme
j. Projekti i nderhyrjeve rehabilituese, Detajet, Metodologjia, Preventivi

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q

VLERËSIM I GJENDJES EKZISTUESE TË STRUKTURËS

HYRJE DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Metodologjia e pergjithshme sipas rekomandimeve te shprehura ne Eurokodin 813, dokumentet FEMA dhe ATC bazohet mbi keto etapa:

- Mbledhja e te dhenave ekzistuese per strukturen, historiku, practika e ndertimit dhe projektimit ne kohen kur eshte projektuar dhe realizuar objekti, tipologjia, klasifikimi, vleresimi paraprak si edhe mbledhja e te dhenave mbi kriteret e projektimit sizmik te nderteses (ne koben e projektimit te saj);

- Identifikimi i te dhenave gjeometrike karakteristike per strukturen dhe detajet perkatese (lloji dhe tipologjia e elementeve strukturore, permasat karakteristike te elementeve te ndryshem konstruktiv, themelet elementet vertikale, soletat, traret., arkitraret., koloncinat, brezat si edhe amimi i tyre, amatura gjatesore dhe ajo terthore).

- Identifikimi i karakteristikave te materialeve, nepemjet provave laboratorike, analizes se materialeve, etj.

- Mbledhja e te dhenave mbi demtimet strukturore te tanishme ose te meparshme (nëse ka), duke perfshire riparimet e mundshme që janë kryer ne kohe, historiku, gjendja aktuale

- Rivleresimi i ngarkesave te ushtruara

- Vleresimi strukturor nepermjet analizave lineare sipas kritereve te Eurokodeve

- Vleresimi strukturor nepermjet analizave jolineare (perfshire edhe vleresimin e tabanit/themeleve nese eshte e nevojshme)

- Vleresimi i kapacitetit te elementeve strukturor

- Projekti i nderhyrjeve rehabilituese dhe perforcuese

- Vleresime tekniko-ekonomike

- Perfundime dhe rekomandime

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

PARIMET E PROJEKTIMIT

Nevoja për riaftësim strukturor

Arsyet kryesore të kryerjes së vlerësimit strukturor të ndërtesave ekzistuese janë:

- Jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)
- Vlerësimiet e sotme të rrezikut sizmik;
- Ndryshimet në kodet e projektimit nga koha e ndërtimit deri më sot;
- Dëmtimet e ndryshme që kanë pësuar ndërtesat ndër vite;
- Ndërhyrjet arkitektonike të pa planifikuara

Jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)

Nëse mbajme parasysh kerkesat e kushteve te vjetra te projektimit, apo edhe ato te kushteve te sotme, jetegjatesia e projektimit te ndertesave me perdorim te gjere nga publiku eshte 50 deri ne 100 vite.
Kjo jetegjatesi percaktohet si nje periudhe kohore gjate se ciles struktura eshte e afte te kryeje funksionin e saj pa pasur nevoje per nderhyrje strukturore te rendesishme.

Vleresimet e sotme te rrezikut sizmik

Harta e pare sizmike e Shqiperise eshte përpiluar rreth viteve 1952. Qe nga viti 1952, per shkak te pasurimit te vazhdueshëm me te dhëna, rreziku sizmik eshtë vleresuar gjithmone ne rritje. Ketu ka rendesi te permendet fakti qe per ndertesat qe jane ndertuar perpara vitit 1979, kushtet teknike kane qene te vjetra, por edhe harta e rajonizimit sizmik ka pasur vlera te uleta te intensiteteve sizmike te termeteve te pritshem. Punime te viteve te fundit (sip.sh. ai i UNDP Albania dhe ai i Akademise se Shkencave te Shqiperise) tregojne per rritje te metejshme te vlerave qe perfaqesojne rrezikun sizmik. Ne menyre te përafert, botimet e sotme e vleresojne rreth (0.26 - 0.275 * g) nxitimin reference ne truall te forte per nje periode kthimi 475 vite.
Hartat probabilitare të rrezikut sizmik dhe vlerat e tyre për cdo njësi administrative (IGJEUM)

Bashkia	Njesia Administrative	Probabiliteti i tejkalimit	
		10% ne 10 vjet (njësia: g)	10% ne 50 vjet (njësia: g)
Belsh	Belsh	0.158	0.320
	Grekan	0.152	0.307
	Kajan	0.150	0.303
	Fierzë	0.149	0.303
	Rrasë	0.150	0.306
Berat	Berat	0.145	0.295
	Velabisht	0.146	0.298
	Otllak	0.145	0.296
	Sinjë	0.150	0.303
	Roshnik	0.140	0.286

Natasha Myrtaj
Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

ARENA MK Sh.p.k. NUIS: L67619801Q





Lloji I truallit të cilit I përket qyteti I Beratit është si më poshtë.

Karakterizimi i dherave sipas Eurokodeve

Tipi i truallit	Pershkrimi i profilit stratigrafik	Parametrat		
		$v_{s,30}$(m/S)	N_{SPT} (goditje/30 cm)	c_u(kPa)
A	Shkemb ose formacion tjeter gjeologjik i njejshem me shkembin duke perfshire te shumten 5m material te dobet ne siperfaqe	> 800		

ARENA MK Sh.p.k. NUIS: L67619801Q

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 16:25:19 +02'00'

Klasifikimi i kushteve të truallit në kushtin teknik të projektimit KTP-N.2-89

Kategoria e truallit	Përshkrimi litologjik i trojeve
I	a. Formacione shkëmbore magmatike, sedimentare, të forta të paaksidentuara nga tektonika, karsti dhe proçeset e tjetërsimit. b. Formacione flishore të fortësisë mesatare të paaksidentuara nga tektonika dhe tjetërsimi; ranorë me çimentim argjilor gipsor e argjilo-ranor.

Parametrat kryesore te rrezikut sizmik. te sheshit te ndertimit ne studim ne kushte trualli shkëmbor (Vs, 30 = 760 m/sek)jane: per periudhe perseritje 475 vjet shpejtimi maksimal PGA = 0.270 g, ndersa shpejtimi spektral ne perioden 0.2 sek Sa (0.2 sek) = 0.626 g dhe per perioden 1.0 sek Sa (1.0 sek) = 0.183 g.

Mga sa më sipër, qyteti i Beratit nuk klasifikohet në zonë më rrezikshmëri për dëmtime të konsiderueshmë nga tërmetet që mund të cënojnë qëndrueshmërin e godinës për të cilën do të kryhen punimet e mirëmbajtjes.

Ndrshimet në kodet e projektimit

Në fushën e inxhinierisë civile dhe asaj të tërmeteve janë bërë zhvillime shumë të mëdha, që nga koha kur ndërtesat ekzistuese janë projektuar dhe zbatuar. Kushtet Teknike të Projektimit në fuqi në vendin tonë (KTP-78 dhe KTP-N.2-89) datojnë që prej vitit 1978, pra ata janë tashmë 46 dhe 35 vjecare. Megjithëse përmirësimi i fundit i KTP-78 i bërë në vitin 1989 (KTP-N.2-89) është një kod projektimi që pasqyron mirë kërkesat e kohës së tij, ai qëndron relativisht shumë larg në shumë prej kërkesave bashkëkohore të projektimit sizmik, të cilat duhet theksuar që në Shqipëri nuk janë të miratuara në rrugë ligjore.

Dëmtimet që ka pësuar ndërtesa

Në ndërtesën ekzistuese nuk vihen re dëmtime të zhvilluara në vite. Në Godinën Qëndrore të Spitalit Berat, e cila është një godinë 4 kt, është kryer rikonstruksioni i plotë i tre kateve të saj me parë ku edhe pas të cilit(rikonstruksionit) objekti nuk rezulton me probleme në strukturë, sepse ndërhyjet kanë qenë të lidhura kryesisht me punime rifiniture (suvatime prishje -berje , pllaka dyshemeje heqje- shtrim, dyer- dritare heqje vendosje, rrjete instalimesh te ndryshme te sisteme teknike si: elektrik+ hidraulik+ ngrohje+ mbrojtje nga zjarri,lyerje me bojë).

Nderhyrjet ne murature kane qene vetem me hapjen e ndonje dere te brendshme dhe shtimit te ndonje muri ndares t=12cm me material te lehtesuar(mure me knauf apo tulle me vrima) .

Ne vijim te sa me siper sqarojme qe edhe ne Godinen Qendrore - Kati i parë te Spitalit Berat, te cilit i eshte parashukuar rikonstruksioni me kete projekt -preventiv nuk jane verejtur probleme me qendrueshmerine e mureve dhe per kete arsye nuk jane parashikuar nderhyrje që lidhen me aftësinë dhe qëndrueshmërinë strukturore të objektit. ***Konstruksioni i saj është në gjendje shumë të mirë dhe nuk do të preket.***

Gjate Rikonstruksionit te Godines Qendrore - Kati i parë ,ne Spitalin Berat, nderhyrjet e parashikuara jane teresisht me punime rifiniture (suvatime prishje -berje , pllaka dyshemeje heqje- shtrim, dyer- dritare heqje vendosje, rrjete instalimesh te ndryshme te sisteme teknike si: elektrik+ hidraulik+ ngrohje+ mbrojtje nga zjarri,lyerje me bojë) pra nderhyrjet ne murature do te jene vetem hapje e ndonje dere te brendshme /shtimi i ndonje muri ndares t=12cm me material te lehtesuar(mure me knauf apo tulle me vrima).

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

ARENA MK shpk
NUIS: L67619801Q

Gjeometria dhe hollësitë strukturore

Gjeometria dhe hollësitë strukturore duhet të merren nga një kombinim midis të dhënave të paraqitura në projektet origjinale dhe vizitave në vend dhe do të shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë me projektet origjinale.

Të dhëna mbi materialet

Në kuadër të këtij rikonstruksioni, konsulenti do të kryej prova laboratorike para dhe gjatë punimeve , nëse i shikon të arsyeshme dhe nëse materialet ekzistuese rezultojnë të dëmtuara dhe nuk janë të sigurta për qëndrueshmërinë e godinës. Pozicionot e marrjes së provave do të evidentohen në mënyrë të saktë në planimetri dhe altimetri dhe gjithashtu do të shoqërohen me foto reale. Rezultatet e provave do të evidentohen dhe pasqyrohen qartë në një raport të detajuar, të përpiluar nga laboratori i specializuar dhe i licensuar.

Inspektimi i gjendjes ekzistuese

Është hartuar një raport teknik paraprak bazuar në vizitat dhe inspektimet në vend. Këto vizita/inspektime kanë për qëllim evidentimin e mangësive të mundshme strukturore ose jo, deformimeve, carjeve apo problemeve të tjera që mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Ambjentet ne nivelin e katit perdhe e te pare , te cilat do ti nenshtrohen rikonstruksionit pozicionohen ne 3 fragmente te objektit qendror te Spitalit Rajonal Berat. Ambjenti ne pjesen perendimore (seksioni A) aktualisht jane pjeserisht jashte funksionit si rrjedhoje e gjendjes se degraduar te rifiniturave dhe investimit te ri ne urgjencen e re te Spitalit Rajonal Berat.

1.Kati Perdhe Seksioni A – Siperfaqe 350m² 2.Kati Perdhe Seksioni B + Farmacia – Siperfaqe 440m² 3.Hapsira e Administrates (Ekzistuese) Nyje Sanitare – Siperfaqe 18m².
Ambjentet ne Pjesen lindore te Seksionit A, organizohen ne disa ambjente vizitash (dy dhoma mjeku kur njera prej tyre ka nyje te vecante sanitare) dhe tre ambjente te cilat jane ne funksion te radiografise dhe paisjes se ekografise me ambjentet teknike perkatese si garderobe, dhome kontrolli dhe dhoma teknike e paisjes se radiografise. Aktualisht keto ambjente jane te organizuara ne nje diference kuote kundrejt koridorit qarkullues I cili I eshte nenshtruar nje nderhyrje te meparshme. Nderhyrja e re parashikon nje rikonstruksion te ketyre ambjenteve dhe nje nivelim te kuotes se dyshemese se ketyre ambjenteve me kouten e trotuarit qarkullues.

Ambjentet e Seksionit B (ne pjesen qendore te objektit ne nivelin e katit perdhe) organizohen ne 5(pese) ambjente zyrash mjeku, nje ambjent te madh gjatesor magazinimi dhe dy ambjente nyjesh sanitare ne pjesen fundore. Koridori qendor me gjeresi 225cm realizon shperndarjen per ne keto ambjente dhe lidhjen horizontal me seksionin terthor te katit perdhe I vendosur ne nje disinivel kuote 65cm kundrejt kuotes se koridorit te seksionit B. Ambjenti Farmacise pozicionohet ne katin perdhe, ne pjesen jug-perendimore te godines kryesore te spitalit. Hyrja ne koridorin kryesor qarkullues realizohet permes portes metalike ne hollin e hyrjes ne katit perdhe.
Hapsira organizohet ne 5(pese) ambjente magazinimi per medikamentet, ne nje ambjent zyre te perbashket me 4(kater) vende pune, dhe ambjentin e nyjeve sanitare ne pjesen qendrore te krahut verior.

Natasha Myrtaj
Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

Projektim Ndërtimi Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q



Kati Perdhe

GJEDJA EKZISTUESE - SEKSIONI A

GJEDJA EKZISTUESE - SEKSIONI B

Fig.2 – Foto te Gjendjes Ekzistuese te Ambjenteve te Brendshme.

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

ARENA MK Sh.p.k. NUIS: L676198016

Fig.1 – Planimetria e Katit Perdhe / Pozicioni ambjenteve Seksioni A,B dhe Farmacia.

Theksojmë se nga inspektimi në vend i gjendjes reale të objektit nuk janë konstatuar dëmtime si carje, plasaritje, përkulje të elementëve mbajtës, probleme të theksuara me lagështinë që mund të cojnë në ulje të aftësisë mbajtëse të mureve mbajtës të godinës.

Historia e dëmtimeve nga tërmete të shkuara

Berati mori pamjen e sotme në shek. XVIII dhe sidomos në shek. XIX, pas tërmetit të vitit 1851. Mbi 400 të vdekur dhe shkatërrime të shumta në ndërtesa. Plasaritje të mëdha, rrëshqitje toke dhe pluhur me squfur.

Në vitin **2010** një tjetër tërmet godet Beratin. Autoritetet lokale thanë se për momentin nuk raportohen viktima dhe dëme materiale.Ndërkohë, sizmiologu Ervin Kasaj saktësoi se fuqia e tërmetit ishte 4.1 ballë e shkallës Rihter.i njëjti burim ka shtuar se epiqendra e tërmetit është lokalizuar 9 kilometra në perëndim të Beratit, ndërkohë që lëkundja është ndjerë edhe në Fier.

27/01/2017

Një tërmet me Magnitude 4.8 ballë është ndjerë në disa qytete. sipas Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), tërmeti është ndjerë në qytetet Vlorë, Fier, dhe Berat, ndërsa epiqendra ka qenë 7 kilometra nga Ura Vajgurore, 15 kilometra nga qyteti i Beratit dhe 61 kilometra nga Tirana. Tërmeti ka qenë me një thellësi 3 kilometra dhe për pasojë lëkundjet kanë qenë të forta, por pa dëme materiale serioze apo dëmtime të objekteve që rrezikojnë jetën e qytetarëve.

Nisur nga këto të dhëna, konstruksioni i objektit në fjalë i ka rezistuar kohës më së miri dhe ende sot nuk paraqet probleme në qëndrueshmërinë e tij.

Projektim - M... - Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801O

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

a. Dokumentacioni Gjeometrik dhe Teknik I Strukturës së Objektit



Fig.3 – Planimetria e katit Perdhe - Seksioni A / Planimetria e Katit Perdhe – Seksioni B + Farmacia

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E SHËNDETËSISË	Autoriteti Kontraktor : DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL BERAT	Projektues :	Faza : PROJEKT ZBATIMI	Emërtimi i Fletës :		Kapitulli :	ARKITEKTURA
	Emërtimi i Projektit : RIKOMPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHUË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE	ARENA MK Sh.p.k	"Arena Mk" shpk nr.Licence : N 6774/6 Instituti Dekliada Alb	Gjedja Ekzistuese Planimetria e Katit Perdhe - Seksioni A		Nr. i Fletës :	A - 01
				Shkalla e Vizatimit : Sh 1:120	Formati i Vizatimit : A3	Data :	BERAT - 2023



REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E SHËNDETËSISË	Autoriteti Kontraktor : DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL BERAT	Projektues :	Faza : PROJEKT ZBATIMI	Emërtimi i Fletës :		Kapitulli :	ARKITEKTURA
	Emërtimi i Projektit : RIKOMPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHUË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE	ARENA MK Sh.p.k	"Arena Mk" shpk nr.Licence : N 6774/6 Instituti Dekliada Alb	Plani i Nderhyjes - Propozimi Planimetria e Katit Perdhe - Seksioni A		Nr. i Fletës :	A - 02
				Shkalla e Vizatimit : Sh 1:120	Formati i Vizatimit : A3	Data :	BERAT - 2023

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E SHËNDETËSISË	Autoriteti Kontraktor : DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL BERAT	Projektues :	Faza : PROJEKT ZBATIMI	Emërtimi i Fletës :	Kapitulli : ARKITEKTURA
	Emërtimi i Projektit : RIKONPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHIHË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE	ARENA MK Shpk "Arena Mk" shpk Nr Licence : N 6774/6 Instituti Dekliada Alb		Gjedja Ekzistuese Planimetria e Katit Perdhe - Seksioni B	Nr. i Fletës : A - 08 Shkalla e Vizatimit : Sh 1:120 / Formati i Vizatimit : A3 / Data : BERAT - 2023



REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E SHËNDETËSISË	Autoriteti Kontraktor : DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL BERAT	Projektues :	Faza : PROJEKT ZBATIMI	Emërtimi i Fletës :	Kapitulli : ARKITEKTURA
	Emërtimi i Projektit : RIKONPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHIHË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE	ARENA MK Shpk "Arena Mk" shpk Nr Licence : N 6774/6 Instituti Dekliada Alb		Plani i Ndërhyjes - Propozimi Planimetria e Katit Perdhe - Seksioni B	Nr. i Fletës : A - 09 Shkalla e Vizatimit : Sh 1:120 / Formati i Vizatimit : A3 / Data : BERAT - 2023

Projektim - Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

b. Studimi gjeometrik dhe studimi i detajimeve të pjesës strukturore të ndërtesës

Struktura e objektit është e konceptuar dhe realizuar me konstruksion mbajtës tip mure mbajtëse-materiali tull e plote, ku ngarkesat sizmike përballohen nga këto të fundit. Objekti i jep prioritet të dy drejtimeve perpendikulare për garantimin e zhvendosjeve të lejuara nga veprimet e ngarkesave të jashtme. Strukturat horizonatle përfaqësohen nga elemente betonarme si soleta më trashësi 20-25 cm. Largësia ndërmejt mureve mbajtës me trashësi 55 cm nuk i kalon 5 m duke i dhënë prioritet të dy drejtimeve perpendikulare të objektit për të garantuar zhvendosjet e lejuara nga veprimet e ngarkesave.
Muret dhe soletat , nga inspektimi në vend nuk kanë dëmtime strukturore që cënojnë qëndrueshmërinë totale të strukturë dhe jo vetem të katit në të cilën do të ndërhyet.

Nderhyrja e rikonstruksionit nuk do te prek strukturen dhe muret ndarese ekzistues, duke ruajten te njejtin organizim funksional. Seksioni A, do te pesoj nje rikonceptim te hapsires se nyjeve sanitare, duke realizuar nje organizim te ri me mure ndares 12cm me tull te lehtesuar. Hapsira e dhomes se komandimit ne krah te dhomes se radiografise do orgaziohet ne tre ambjente, ku ambjeti shtese do te shebej si ambjent garderobe.

Ne ambjentet e nyjeve sanitare te seksionit B, do te rikonceptohen ndarjet e brendeshme permes mureve te reja me tulla me vrima 12cm, duke krijuar nje bllok me dy hapsira sanitare dhe nje nyje sanitare per personat PAK. Do te rikonceptohen edhe ndarjet e brendeshme ne ambjentin sanitar ne zonen e zyrave ekzistuese te administrates, duke organizuar tre ambjente sanitare te vecuara. Rifinitura e dyshemese do te zvendesohet me nje shtrese te re pllakash gres 60x60cm me ngjyre te bardhe. Muret e brendshme do te suvatohen dhe lyhen me boje hidro-plastike me tonalitet te bardhe. Tavani do te realizohet i varur me pllaka gipsi 60x60cm. Dyert e brendshme do te realizohen me strukture druri dhe strukture dural (per nyjet sanitare) ku kasa perimetrale do te trajtohet me boje tonalitet gri, ndersa pjesa tjeter e deres me boje me tonalitet te bardhe. Nderhyrja e propozuar synon unifikimin e ketyre ambjenteve me ambjente ne te cilat eshte realizuar nje nderhyje e meparshme rikonstruksioni, per te krijuar nje ambjent uniform.

Shenime dhe specifikime teknike per projektin :

1. Dyshemeja e objektit do te trajtohet me pllaka gres 60x60 ngjyre te bardhe, te trajtuara me plintus perimetral gres me te njejtat cilesi si pllaka e shtrimit, me lartesi 10cm.
2. Tavani do te trajtohet ne formen e tavanit te varur te realizuar me pllaka 60x60xm (ulja e tavanit nga kuota e soletes do te realizohet 30-35cm ne varesi te paisjeve teknike tavanore), do te patinohet dhe lyhet me boje hidro-plastike tonalitet te bardhe RAL – 9016.
3. Muret e jashtme (ekzisutes) me tulle 55cm nuk do nderhyet. Muret e brendshme ekzistues12cm,/20cm/25cm , do te suvatohen dhe lyhen me boje hidro-plastike tonalitet ngjyre te bardhe, RAL – 9016. Muret e brendshme 12cm, do te realizohen me strukture tulla me virma, do te suvatohen dhe lyhen me boje hidro-plastike tonalitet ngjyre te bardhe, RAL – 9016.
4. Dyert e brendshme do te realizohen me strukture dhe kase druri (per ambjentet e dhomave dhe zyrave) dhe do te lyhen me boje me tonalitet te bardhe RAL-9016. Dyert e nyjeve sanitare do te trajtohen me strukture dhe kase dural dhe do te lyhen me te njejten tonalitet boje te bardhe. Menyra e hapjes dhe permasat do te realizohen sipas specifikimeve dhe vizatimeve teknike te projektit.

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'

Projektues - Miratuar Kolaudim
ARENA MK Sh.p.k
NUIS: L67619801Q

5. Muret e brendshme te ambjenteve te radiografise dhe ekografise do te trajtohen me pllake karton xhes kundra rrezatimit, per te siguruar mbrojtien e stafit mjeksor dhe perdoruesve te tjere nga niveli I larte I rezatimit te emetuar nga funksionimi I paisjve ekzaminuese.

Ndodhur në këto kushte, inxhinierët tanë janë të mendimit së një studim i thelluar strukturor me programe të specializuara inxhinierike, (të cilat në këtë situatë përkthehen në kosto financiare dhe kohore të panevojshme), nuk është i nevojshëm. Godina është e qëndrueshme. Nëse , gjatë zbatimit të punimeve të mirëmbajtjës së planifikuar sipas project-preventivit të propozuar, do të vërehen dëmtime në sistemet mbajtëse, duhet ti behen njoftimet perkatese projektuesit dhe objekti do te ti nënshtrohet analizës së thelluar.

KONKLUZIONE:

- ***Projekti "RIKOMPOZIM I KATIT TË PARË E CILA DO TË PËRFSHIJË NDËRHYRJE NË ATO PJESË QË NUK ËSHTË BËRË NDRYSHIME APO RIKONSTRUKSIONE", konsiderohet ndërhyrje vetëm për punimet e rifiniturës, pra vetëm punime shtresash dhe veshje te brendshme.***

- ***Struktura ekzistuese është në gjendje shumë të mirë konstruktive dhe nuk është e nevojshme analiza e detajuar në programe kompjuterike deri në një moment të dytë problematik, të linduar/ zbuluar gjatë punimeve.***

PUNOI :"ARENA MK"sh.p.k Lic.N.6774/8
Ing.Diana Terezi, Lic.K.1317/3
Ing.Natasha Myrtaj, Lic.K.1241/2
Ing.Drita Beqiri

ARENA MK Sh.p.k NUIS: L67619801Q

Natasha Myrtaj

Digitally signed by Natasha Myrtaj
Date: 2025.06.05 15:25:19 +02'00'